

SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

Ngatërrimi / *el-Telbis* / التَّيْبِيسُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

Allahu ﷻ tha:

"وَلَلْبَسْنَا عَلَيْهِمْ مَا يُلْبِسُونَ"

"... dhe Ne do t'ua ngatërronim atyre atë çfarë ata e bëjnë të ngatërrueshëm."¹ (el-En'am, 9)

Ngatërrimi është të mbulosh një qenie ekzistuese (realitet) me një shenjë treguese të huazuar. Kjo ka tri kuptime.

I pari është ngatërrimi i Vërtetë që u bëhet njerëzve të shkapërderdhjes me anë të universit. Kjo bëhet duke lidhur gjërat / ngjarjet ekzistuese me shkaqet, me vendet e me kohët, dhe me lidhjen që Ai bën mes realizimeve dhe mjeteve, mes fakteve dhe provave, mes vendimeve dhe faktorëve përcaktues, mes ndëshkimeve dhe shkeljeve, dhe mes shpërblimeve me aktet e dëgjueshmërisë. Ai fshehu kënaqësinë dhe hidhërimin që përligjin ndarjen dhe lidhjen, gjë që sjell vuajtjen dhe lumturinë².

¹ Në *Medaarixh*, Imam Ibn el-Kajjim e pa si të pavend këtë ajet për temën në fjalë. Ky është konteksti më i gjerë i kësaj:

"Dhe ata thonë: 'Pse nuk i zbriti një engjëll?' Por, sikur Ne të zbritnim një engjëll, puna do të përfundonte dhe atyre nuk do t'u shtyhej ndëshkimi. Dhe, sikur Ne ta bënim atë (të dërguarin) një engjëll, do të bënim që ai të shfaqej si një njeri dhe Ne kësisoj, sigurisht, do t'ua ngatërronim atyre atë çfarë ata e bëjnë të ngatërrueshëm." (el-En'am, 8-9)

² Tërë kjo duhet të kuptohet në kontekstin e te qenit e kësaj jete një sprovë. Sikur njerëzve t'u manifestoheshin të gjitha realitetet, s'do të kishte sprovë. Disa dukuri fshehin realitetet mbrapa tyre për ata të cilëve u mungon qartësia. Këtu është me rëndësi të theksohet se pozita e saktë mes Ehlus-Sunetit është se shkaqet mbartin në vetvete fuqinë që ua ka dhënë Zoti për të çuar deri të rezultatet e tyre, megjithëkëtë Ai vazhdimisht krijon, posedon dhe kontrollon shkaqet, pasojat, dhe vetë raportin rastësor.

Ngatërrimi i dytë është atëherë kur njerëzit e xhelozisë mbrojtëse (*ghajreh*) mbulojnë kohët (e punëve të mira) dhe *kerametet* (dhuratat e mbinatyrshme) për t'i fshehur ato³, duke ngatërruar të tjerët me anë të shkaqeve e pasojave dhe me anë të shenjave treguese e rrethanave shkrepëse, në mënyrë që t'i ngatërrojnë sytë e dobët dhe mendjet e mangëta, ndërsa përsosin përcaktimin e vet të besimit dhe të zbatimit⁴. Ky grup është një mëshirë nga Allahu për njerëzit e shkapërderdhjes dhe të shkaqeve, kur përzihen me ta⁵.

Ngatërrim i tretë janë njerëzit e vendosjes, që ngatërrojnë njerëzit nga mëshira që kanë për ta duke i angazhuar me shkaqet dhe për t'u sjellë lehtësim e mundësi atyre, jo vetëve të tyre. Kjo është shkalla e pejgamberëve dhe është për imamët e devotshëm, që vijnë nga lugina e Bashkimit dhe tregojnë për thelbin e tij (bashkimit)⁶.

³ Ata fshehin punët e tyre të mira dhe fshehin çfarëdo *kerameti* që pranojnë nga Zoti, përveç nëse ka ndonjë dobi të madhe në zbulimin e tyre, siç është rasti kur ka nevojë t'u ndihmohet besimtarëve dhe të forcohet vendosmëria e tyre në kohë të vështira.

⁴ Ndërsa angazhohen në të gjitha shkaqet, ata janë të sigurt për kontrollin absolut të Allahut dhe ushtrojnë një mbështetje të plotë në Të.

⁵ Pavarësisht nga gjendja fisnike e brendësisë së tyre, e jashtëmja e tyre nuk është shumë e ndryshme nga ajo e njerëzve të tjerë, duke e bërë kështu të lehtë për ta të përfitojnë dobi nga shoqërimi me ta.

⁶ Shejhu (el-Harawi) mund të ketë menduar atë se të Dërguarit dhe pararojat ndër robërit e devotshëm u angazhuan në shkaqe vetëm që t'ua lehtësonin gjërat njerëzve ndërsa e dinin se ato nuk janë të vlefshme (D.m.th. pa lejen e Allahut, zjarri nuk djeg, uji nuk shuan etjen, thika nuk pret, etj.). Allahu ka nën kontroll të gjitha gjërat dhe, u angazhove apo s'u angazhove në shkaqe, do të ndodhë vetëm ajo që Allahu ka caktuar. Nëse kjo është çfarë mendoi shejhu, atëherë kjo është problematike. Të Dërguarit erdhën për të na mësuar çka është mirë, jo për të na ngatërruar; erdhën për të na udhëhequr deri te mirëqenia jonë në këtë jetë dhe deri në shpëtimin në botën tjetër. Angazhimi në shkaqet që Allahu i bëri për t'u arritur përfundimet e dëshiruara, është diçka që kërkohet prej nesh. Nëse na merr uria dhe ne nuk hamë, derisa të vdesim, do të përgjigjemi para Tij. Angazhimi në shkaqe nuk dëmton besimin tonë në kontrollin dhe fuqinë e Tij; angazhimi është një përgjigje e bindur në instruksionet e Tij. Formula është e përsosur dhe e thjeshtë. Enes ibn Malik përcolli se një burrë tha (për devenë e tij): "O i Dërguar i Allahut, ta lidhi, apo të mbështetem (në Allahun)?" Ai ia ktheu: "Edhe lidhe, edhe mbështetu (në Allahun)" (et-Tirmidhi). Kështu vepronte vazhdimisht i Dërguari ﷺ. Dhe migrimi nga Meka në Medine është shembulli epik i përzierjes së angazhimit në shkaqe dhe mbështetjes në Allahun.